

VENDIM
Nr. 483, datë 3.8.2012

PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË ME NJË EKIP SHËNDETËSOR NË OPERACIONIN USHTARAK “ISAF”, AFGANISTAN

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6 pika 5 e 7 të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005 “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, të pikave 6 e 11 të nenit 14 të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dërgimin e një ekipi shëndetësor të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë në operacionin ushtarak “ISAF”, Afganistan.

2. Autoriteti i drejtimit operacional për ekipin shëndetësor të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, për kohën e qëndrimit në mision, është Komanda e Ekipit Këshillues Mjekësor të NATO-s (NTM-A), që vepron në Komandën Rajonale Qendrore të Operacionit “ISAF”, në Kabul, Afganistan.

3. Misioni i ekipit shëndetësor të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë është mbështetja dhe këshillimi i personelit shëndetësor afgan, në Akademinë e Shkencave Mjekësore të Forcave të Armatosura Afgane.

4. Ekipi shëndetësor pjesëmarrës në këtë operacion përbëhet nga 10 (dhjetë) ushtarakë, nga të cilët 2 (dy) mjekë dhe 8 (tetë) infermierë.

5. Kohëzgjatja e këtij misioni është 1 (një) vit, afat i cili fillon të llogaritet nga data e dërgimit të ekipit të parë shëndetësor në mision. Kohëzgjatja për çdo rotacion është 6 (gjashtë) muaj, periudhë së cilës i shtohen edhe ditët për ndërrimin me kontingjentin e radhës.

6. Ministria e Mbrojtjes të përballojë, për ekipin shëndetësor pjesëmarrës në këtë operacion, shpenzimet për:

- a) shpërblimin për vështirësi shërbimi, në masën 9 000 (nëntë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;
- b) sigurimin e jetës;
- c) shërbimin telefonik celular dhe satelitor, si dhe shërbimin postar;
- ç) transportimin e individit/ve të shkëputur të misionit për në atdhe për raste sëmundjesh dhe thyerje disipline;
- d) veprimtari social-kulturore;
- dh) çdo shpenzim tjetër të nevojshëm për mbarëvajtjen e kryerjes së operacionit.

7. Ministria e Mbrojtjes të bëjë sigurimin e jetës nga aksidentet në grup të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, që do të marrë pjesë në këtë mision.

8. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Ministrinë e Mbrojtjes.

9. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha